KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit:** **27.06.2025**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **651-25-4477-5-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN** | | |
| **Adresa Postare**: **SKENDERBEU** | | |
| Qyteti: **GJILAN** | Kodi postar: **60000** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Rrezelina Uka**<br>**Personi Përgjegjës: Kujtim Bajrami** | | Telefoni: **+383 12345678** |
| Email: **prokurimigjilan@rks-gov.net** | | Faksi: **N/A** |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): **https://mail.rks-gov.net** | | |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Rrethrrotullimi-Nyja Kryesore, Rruga e Prishtinës, Rruga Qarkore**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☒ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☒ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Në Komunën e Gjilanit**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Rrethrrotullimi-Nyja Kryesore, Rruga e Prishtinës, Rruga Qarkore**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

45000000-7

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 340,000.00**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**Sipas përshkrimit në Aneksin 1 Specifikat Teknike të detyrueshme të DT si dhe Listës së përshkrimit të çmimeve.**

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj 24 apo ditë (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

## III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vlerës se kontratës me afat validiteti jo me pak se 775 nga data e nënshkrimit te kontratës.** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

| |
|---|
| **Po** ☐ **Jo** ☒<br><br>***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga https e-prokurimi.rks-gov.net HOME ClanakItemNew.aspx id=303** | **Dëshmia 1 1.Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b.Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken 2 dhe 3 Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte. Ne rast te ofertimit si grup i OE, secili anëtar duhet te përmbush kërkesat e përshtatshmërisë** |

| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit** | **Dëshmia 1 Kopja e Certifikatës se biznesit** |
| **Kërkesa 2.Certifikata e TVSH-së** | **Dëshmia 2.Kopja e certifikatës se TVSH-së** |

| III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| --- | --- |
| **Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-ës se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik (në rast të ofertimit si konsorcium, lideri duhet të përmbush së paku 60% të kërkesës), gjatë tre viteve të fundit fiskale (2022-2023-2024) ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 450,000.00 Euro.** | **Dëshmia 1. Kopje të Deklaratave Tatimore te dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës ose vendit te themelimit për tri vitet e fundit 2022-2023-2024 (tri vite duhet te jene vite te plota fiskale),apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te çertifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur, për tri vitet e fundit fiskale (2022-2023-2024). Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ.** |
| **Kërkesa 2. Kapital financiar të mjaftueshëm (mjete të gatshme në xhirollogari) në bankë për realizimin e kontratës nga kompania (në rast të ofertimit si konsorcium, lideri duhet të përmbush së paku 60% të kërkesës) në vlerë prej së paku 100,000.00 ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia.** | **Dëshmia 2.Një dokument bankar (vërtetim, konfirmim) nga një bankë që dëshmon se operatori ekonomik ose grupi i tillë i operatorëve ekonomik, disponon me mjete të gatshme në llogarinë bankare) në shumën të paktën prej 100,000.00€ (dyqind mijë euro), apo Një [1] vërtetim ose konfirmim nga një Bankë, i cili dëshmon se operatori ekonomik ose grupi i tillë i operatorëve ekonomik, disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar për financimin e këtij projekti (me emër dhe numër të prokurimit), në shumën 100,000.00€ (dyqind mijë euro).Shënim Dokumentet e mësipërme duhet te jenë të skanuara nga origjinali, dhe të nenshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.Data e lëshimit nuk duhet të jetë më e hershme se data e publikimit të njoftimit për kontratë dhe më e vonshme se data afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.** |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **Kërkesa 1. Operatori ekonomik (në rast të ofertimit si konsorcium, lideri duhet të përmbush së paku 60% të kërkesës) duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në nga lëmia e objektit të punimeve të kontratës. në vlerë të përgjithshme jo me pak se 450,000.00 Euro, gjatë periudhës se shkuar 3 (tre) vjeçare, cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate.** | **Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotesuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten çertifikatat raportet e përkohshme të pranimit të punëve. Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezantoj dëshmi kopje te çdo dokumenti të nënshkruar nga bleresi së bashku me dëshminë e pagesës transaksionit bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë, referencë, faturë,etj.** |
| **Kërkesa 2. Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve që janë objekt i kësaj kontrate, duhet të ketë në përbërje të stafit, personelin kryesor profesional, punonjësit teknik dhe të kualifikuar në profile të ndryshme siç specifikohet në kërkesat përkatëse, me sa vijon 2.1. Menagjeri i projektit – Një (1) Inxhinier i** | **Dëshmia 2. Për çdo profil të punonjësve si më sipër, duhet të paraqitet dokumentet si më poshtë • Lista e punonjësve të OE pjesëmarrës me të cilën specifikohen të dhënat e stafit të punësuar ose angazhuar (emri, mbiemri, kualifikimi profesional, pozita e punës,etj) për ekzekutimin e kontratës siç** |

| | |
|---|---|
| **diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (ose master), me së paku 5 vite përvojë pas diplomimit, i cili është përgjegjës për drejtimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të projektit dhe duhet të ketë menaxhuar së paku një projekt (kontrate) nga lëmia e objektit të punimeve të kontratës. I njejti duhet të jetë i çertifikuar për Menaxhim të Kantierit nga një subjekt i licencuar dhe relevant per aftesimin profesional 2.2 Udhëheqës i punishtes- Një (1) Inxhinier i dip. i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv (ose master) me së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projekte të realizuara në lëminë e kërkuar. 2.3 Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimatrisë – Drejtimi i Hidroteknikës (ose master), së paku 3 (tri) vite përvojë punë profesionale pas diplomimit në projekte të realizuara në lëminë e kërkuar. 2.5 Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, ose Barchelor i diplomuar i Gjodezisë me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, në projekte të realizuara në lëminë e kërkuar. 2.6 Një (1) Bachelor i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) ose Bachelor i diplomuar i komunikacionit me tri vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëminë e kërkuar. 2.7 Një inxhinier i diplomuar ne menaxhimin e emergjencave ose bachelor ne menaxhimin e emergjencave, me jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion pas diplomimit, dhe duhet te kete te kryer trajnimin per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) ose MFPT (Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve). 2.8 Tre (3) Teknikë të diplomuar të Dy Teknike të ndërtimtarisë,Një Teknike të Elektroteknikës me se paku 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit në projekte të realizuara në lëminë e kërkuar. 2.9 OE pjesëmarrës duhet të paraqes punëtorë të çertifikuar të profileve te ndryshme profesionale nga një institucion publik ose privat i licencuar në Republikën e Kosovës në qendrat programet e aftësimit profesional për këto profesione, së paku nga një (1) për secilin profil profesional si në vijim një (1) armirues, një (1) instalues për instalime elektrike, një (1) instalues për ujësjellës dhe kanalizim Të njejtit duhet të kenë 3 vite përvojë pune profesionale pas çertifikimit në profilin e caktuar profesional. 2.10 Një punonjës të angazhuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë i pajisur me çertifikatë ose çdo akt juridik relevant (vendim, vërtetim) që dëshmon se është i Çertifikuar si Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë nga** | **përcaktohet në kërkesat e dosjes së tenderit, e cila duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali, e nënshkruar dhe vulosr nga OE pjesëmarrës. • Lista e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (formati fizik ose elektronik e-shërbime) e skanuar nga origjinali, e cila zbatohet për të punësuarit e rregullt të OE pjesëmarrës që janë deklaruar në ATK, për periudhën të paktën 6 muajt e fundit, qe paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate. Krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet të paraqiten edhe dëshmitë dokumentare si në vijim Dëshmia 2.1-2.7 Për secilin profil të stafit kryesor dhe profesional të kërkuar, OE pjesëmarrës duhet të paraqes •CV (e nënshkruar nga vet inxhinieri përkatës), e cila duhet të përmbajë përvojën profesionale për projektet e realizuara menaxhuara nga lëmia e objektit të punimeve sipas kontratës (së paku një projekt), pas arritjes diplomimit të kërkuar; [Kopje nga origjinali] • Diploma universitare për secilin profil të inxhinierëve të kërkuar [Kopje nga origjinali] • Kontratë pune e vlefshme me punëdhënësin (mund të anonimizohen të dhënat personale siç janë data e lindjes, numri personal, paga, numri i llogarisë bankare) [Kopje nga origjinali] apo • Në rast se OE pjesëmarrës nuk ka në përbërjen e stafit të tij inxhinierët e kërkuar si më lart, atëherë mund të angazhojë ata duke prezentuar si dëshmi të skanuar nga origjinali Marrëveshje ose (para)kontratë për punë dhe detyra specifike për angazhimin në këtë projekt duke specifikuar titullin dhe numrin e prokurimit të këtij projekti, dhe me një dispozitë te veçantë duhet të specifikohet se inxhinieri i paraqitur duhet të jenë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet gjatë realizimit të projektit. • Referenca ose Vërtetime të punës për secilin inxhinier të paraqitur, mbi përvojën profesionale të mëparshme në fushën përkatëse të kërkuar, të lëshuara nga punëdhënësit. [Kopje nga origjinali] • Për kërkesën 2.1 -2.2 duhet të paraqitet Vendimi mbi caktimin e menaxherit të projektit dhe Çertifikata për Menaxhim të Kantierit për menaxherin e projektit (kërkesa 2.1), Vendimi mbi caktimin e udhëheqësit të punishtes për këtë projekt, të cilat duhet të jenë të vulosura si dhe nënshkruara nga dy palët për dy rastet [Kopje nga origjinali] • Për kërkesën 2.7 (inxhinierin e menaxhimit te emergjencave ose bachelor), duhet të paraqitet edhe Çertifikata për përfundimin e trajnimit nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit në punë, e lëshuar nga subjektet e licencuara nga MPMS** |

| | |
|---|---|
| **MPMS ose MFPT në përputhje me Ligjin nr.04 L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Rregulloren nr. 01 2021 për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë.** | **apo MFPT për ofrimin e shërbimeve dhe trajnimeve për Siguri dhe Shëndet në Punë. [Kopje nga origjinali] Vëmendje! Shënim sqarues Operatori ekonomik nuk mund të angazhojë staf për shërbime të veçanta, zyrtarë publikë që janë në marrëdhënie pune në Komunën e Gjilanit apo ndonjë institucion tjetër publik përfshirë sistemin arsimor (të mesëm dhe universitar) brenda Komunës së Gjilanit, për të përmbushur kërkesat e stafit profesional të kërkuar në kërkesën nr. 1, pikat a, b, c, d, e, f, për këtë aktivitet, për të shmangur konfliktin e interesit, për të mos penguar kryerjen e detyrës zyrtare dhe për të siguruar transparencë në procesin e prokurimit. Përjashtimisht, operatori ekonomik mund të angazhojë me marrëveshje për shërbime të veçanta zyrtarë publikë të institucioneve tjera publike si dhe institucioneve të arsimit publik ose privat jashtë territorit të Komunës së Gjilanit, për sa kohë që ata disponojnë një leje nga punëdhënësi për angazhim në aktivitete të jashtme jashtë orarit të punës dhe një vendim për të shfrytëzuar pushimin vjetor dhe pa pagesë gjatë periudhës që do të kryhen punimet. Këto dokumente duhet të paraqi** |
| **Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete dhe pajisjet teknike në gjendje të rregullt teknike për operim që janë te domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7 OE është i obliguar që pajisjet e prezentuara në listën e pajisjeve ti ketë në selinë e vet (një vend- seli), brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 48 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit. Vërejtje Në rast se gjatë verifikimit të pajisjeve nga vizita në teren (selinë e OE), komisioni i vlerësimit gjenë se nuk janë në vendpunishten e OE pjesëmarrës të gjitha pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm për reralizimin e projektit sipas aneksit 7 të DT dhe se shihet se nuk janë në gjendje të rregullt teknike (jashte funksionit) për operim, OE në fjalë do të shpallet i papërgjegjshëm.** | **ëshmia 3 - Dëshmitë për pronësi, posedim dhe shfrytëzim të mjeteve dhe pajisjeve teknike Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion (në pronësi ose me qera) operatorit ekonomik, që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, si në vijim • Listën për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punëve të projektit, sipas listës të bashkëngjitur në Aneksin 7 të DT.; • Për mjetet pajisjet që regjistrohen, duhet të dëshmohen me paraqitjen e Çertifikatës së regjistrimit të automjetit me afat valid të regjistrimit, që ndërlidhet me rastin e afatit të fundit të dorëzimit të ofertave. • Për mjetet pajisjet tjera që nuk regjistrohen, duhet të dëshmohen me paraqitjen e njërit nga dokumentacioni si në vijim kontrata ose fatura e blerjes, DUD (Dokumenti Unik Doganor) i zhdoganimit. • Ndersa per mjete pajisje te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata ose marrëveshja për marrjen me qera të pajisjeve në emër të këtij aktiviteti, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.** |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**Po** ☐ **Jo** ☐

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

***Nëse po,*** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

**Po** ☐ **Jo** ☐

## NENI IV: PROCEDURA

## IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

**Po** ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është**:

**IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

*ose*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

**Po** ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

***Nëse po***, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

**IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***

***data* 10.07.2025 *koha* 14:00:00 *vendi* Kuvendi Komunal Gjilanit përmesë paltformës së prokurimit elektronik.**

**IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**

☒ **Po** ☐ **Jo**

***Nëse po***, jep arsyetim **Sipas njësisë kërkuese, Duke marrë parasysh rëndësinë e projektit për rrethrrotullimin në rrugën e Prishtinës, kërkojmë që procedura e prokurimit të publikohet me afat të shkurtër, për shkak të nevojës urgjente për realizimin e punimeve. Ky projekt ka ndikim të drejtpërdrejtë në qarkullimin e mjeteve, sigurinë në trafik dhe shmangien e bllokimeve të përditshme në këtë nyje rrugore. Gjendja ekzistuese paraqet rrezik dhe vonesat mund të shkaktojnë kosto shtesë për institucionin dhe qytetarët.**

**IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit **Vlera e sigurisë së tenderit 1.000,00 euro Sigurimi i tenderit duhet te dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit te tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale te sigurimit te tenderit shpije ne zbatimin e nenit 99.2 te LPP-se. Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne 120 ditë.**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** *apo* muaj

**IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**

Deri më: data: ditët **90** apo muajt

**IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**

**data 10.07.2025 koha 14:00:00 vendi Në paltformën e prokurimit elektronik.**

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.**

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**

*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*

**Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimit të Rregullores Nr. 001 2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7 është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup. OE duhet të dorëzojnë tenderët vetëm përmes platformës elektronike. Tenderët e dorëzuar ne kopje fizike, do te refuzohen për nga aspekti administrativ. OE me rastin e aplikimit qoftë individualisht ose si Grup i OE duhen të jenë të regjistruar në Platformën elektronike të prokurimit. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese i Dosjes se Tenderit . Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Shënim shtesë Operatori Ekonomik pas nenshkrimit te kontrates ne koridimin me menaxherin e kontrates te Autoritetit Kontraktues, do të bëjë adaptimin e planit dinamik të dorezuar sipas datës së planifikuar për fillimin e ekzekutimit të punëve. Autoriteti Kontraktues ne pamundësi te ngarkimit te projektit ne E-prokurim për shkak te madhësis se tij. Operatoret Ekonomik i njoftojmë se mund ta tërheqin projektin Ekzekutiv ne formë elektronike CD . Tërheqja mund te behet çdo dit pune prej nga ora 9 00 deri ne ora 15 00 ne zyrën e prokurimit, kati II ,zyra numër 21.**